



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENSIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

NDIHMA ZYRTARE PËR ZHVILLIM PËR BARAZI GJINORE

GJENDJA E PËRAFRIMIT ME PRIORITETET E QEVERISË SË KOSOVËS (2015–2018)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENSIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY FOR GENDER EQUALITY

NDIHMË ZYRTARE PËR ZHVILLIM PËR BARAZI GJINORE

GJENDJA E PËRAFRIMIT ME PRIORITETET E QEVERISË SË KOSOVËS (2015-2018)

MARS 2020

Ky punim është hartuar në mbështetje të iniciativës së Agjencisë për Barazi Gjinore dhe në zbatim të drejtpërdrejtë të Projektit "Forcimi Institucional i Agjencisë së Kosovës për Barazi Gjinore dhe Mekanizmave Gjinorë", i financuar nga Qeveria e Suedisë, Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim, (Sida) dhe zbatuar nga Konzorciumi: Niras & CPM International. Përgjegjësia për përmbajtjen i përket në tërësi autorit. Sida nuk i ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.



NIRAS

CPMI
CORPORATE & PUBLIC MANAGEMENT INTERNATIONAL

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave.....	5
1. Përmbledhje Ekzekutive	8
2. Fushëveprimi dhe metodologjia.....	10
3. Korniza konceptuale për analizë: çfarë po matim?	12
3.1 Dimensionet e përfarimit të NZZH-së	12
3.2 Konteksti vendor: Korniza e politikave të Kosovës	13
3.3 Konteksti vendor: Korniza institucionale.....	15
3.4 Donatorët: NZZH e fokusuar në barazinë gjinore	17
4. Vlerësimi i përafrimit: çfarë thonë statistikat?.....	22
4.1. Përafrimi me fushat prioritare	22
4.2 Dimensionet tjera të përafrimit: çfarë mund të konkludohet?.....	26
5. Dinamika e përafrimit: cilat janë sfidat kryesore?	26
6. Rekomandime.....	32

Lista e shkurtesave

ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
PMN	Platforma për Menaxhimin e Ndihmës
KNZH	Komiteti i Ndihmës për Zhvillim
DAZH	Departamenti i Asistencës Zhvillimore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
ZBGJ	Zyrtar për Barazi Gjinore
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinator
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit
PKBGJ	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore
LBGJ	Ligji për Barazinë Gjinore
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MASHT	Ministria e Arsimit
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
SKTNJK	Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Njerëzve në Kosovë
SKMDHF	Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
NZZH	Ndihma Zyrtare për Zhvillim
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
ZKM	Zyra e Kryeministrit
PDHSK	Parandalimi i Dhunës seksuale në Konflikt
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjencia Suedeze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim
GKSGJ	Grupi për Koordinim të Sigurisë dhe Gjinisë
DPS	Dokumentet e Planifikimit Sektorial
ZPS	Zyra e Planifikimit Strategjik
UNFPA	Fondi i Popullatës së Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia për Ndihmën Ndërkombëtare e Shteteve të Bashkuara
UNWOMEN	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimit të Grave

1. Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim shqyrton shkallën në të cilën NZZH-ja në Kosovë që synon barazinë gjinore u përfrua me prioritetet e qeverisë gjatë periudhës 2015-2018 dhe jep rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Vlerësimi përdor një kombinim të burimeve primare sasiore dhe cilësore – shqyrtim dokumentesh në zyrë, intervista gjysmë të strukturuar, dhe një përmbledhje e të dhënave të Platformës për Menaxhimin e Ndihmës (PMN) për t'u përgjigjur në këto pyetje. Nga periudha 2015-2018, gjithsej 1870 përshkrime projektesh u rishikuan në bazën e të dhënave të PMN-së për të identifikuar dhe kategorizuar projektet me relevancë gjinore.

Vlerësimi ndjek një strukturë dhe rrjedhë të qartë, duke filluar nga pyetjet themelore deri tek analiza më specifike. Së pari, punimi përshkruan kornizën konceptuale për analizën dhe përpqet të artikulojë se çfarë saktësisht jemi duke matur kur përdorim termin "përafrim". Punimi më pas jep prova statistikore (bazuar në bazën e të dhënave të PMN-së) për shkallën në të cilën ka pasur përafrim midis prioritetëve të politikave të qeverisë së Kosovës dhe projekteve të zbatuara nga donatorët. E fundit por jo më pak e rëndësishme, përmes njohurive kuptimplote nga intervistat me agjencitë qeveritare dhe donatorët/partnerët zhvillimorë, vlerësimi bën përpjekje ta kuptojë dinamikën që mundësoi ose parandaloi një shkallë më të lartë të përafrimit.

Punimi identifikon fushëveprimin dhe vëllimin e projekteve me relevancë gjinore si dhe peshën dhe tipologjinë e donatorëve individualë në portofolin e përgjithshëm gjinor. Nga gjithsej 1870 projekte të shqyrtuara, del se 137 projekte kanë pasur relevancë gjinore (duke iu caktuar shënuesin gjinor). Në kuptim të vëllimit, nga gjithsej 695 milion euro NZZH e disbursuar gjatë periudhës 2015-2018, 49.4 milionë euro rezultojnë të kenë relevancë gjinore. Në këtë mënyrë, NZZH me relevancë gjinore paraqet 7.1 për qind të totalit të NZZH-së gjatë kësaj periudhe. Nga kjo NZZH me relevancë gjinore, 27 për qind (104 projekte në total) kishin një shënues gjinor 3 (projekte që kanë prioritet çështjet gjinore). Punimi gjithashtu identifikon donatorët kryesorë dhe e mundëson klasifikimin e tipologjive të ndryshme. Disa donatorë mund të mos kenë portofol të madh të NZZH-së në Kosovë, por projektet që përqendrohen posaçërisht në barazinë gjinore përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të tij. Donatorët e tjerë janë donatorë të mëdhenj të projekteve gjinore por këtë e bëjnë vetëm përmes programeve tematike në të cilat gjinia është ndërlidhëse.

Punimi është në gjendje të vlerësojë shkallën në të cilën NZZH me relevancë gjinore dhe vetë donatorët individualë janë përfruar me prioritetet e Kosovës lidhur me gjininë. Në total, numri më i madh i projekteve me relevancë gjinore (49) ishin të lidhura gjerësisht me prioritetet e qeverisë sa i përket diskriminimit në punë ose arsim, ndërsa numri i dytë më i madh (32) ishte i lidhur gjerësisht me temën e dhunës në familje. Fushat e mbetura prioritare kishin një numër shumë më të vogël të projekteve. Sidoqoftë, gjithsej 53 projekte me relevancë gjinore nuk kishin fokus të qartë në ndonjë nga fushat prioritare. Një ndarje e projekteve sipas vëllimeve tematike të NZZH-së zbulon se një e treta e projekteve të NZZH-së me relevancë gjinore nuk synuan fushat prioritare të përcaktuara nga qeveria.

Punimi vlerëson sfidat kryesore të dëshmuara që parandaluan një shkallë më të lartë të përafrimit. Gjatë kësaj periudhe, në përgjithësi ka pasur lidhje të dobëta të politikave vendore që i

lidhin strategjitë zhvillimore të partnerëve me prioritetet e qeverisë në përgjithësi, dhe se politika gjinore nuk ishte përjashtim. Prioritetet gjinore "harrohen" në dialogun e politikave që partnerët kanë me institucionet e nivelit qendror sepse ky dialog bëhet në një nivel që nuk merr parasysh prioritetet e politikave gjinore. Zhvillimi i programeve dhe projekteve specifike mori në konsideratë perspektivën dhe dimensionet gjinore, por jo domosdoshmërisht në një mënyrë strategjike ose të lidhur me prioritetet e politikave të qeverisë. Aftësia e pamjaftueshme e qeverisë për t'i transmetuar prioritetet e saj gjinore është kryesisht rezultat i fuqizimit të dobët dhe kapaciteteve të institucioneve kryesore përgjegjëse, gjë që përkeqësohet nga preferencat e donatorëve për të punuar përmes partnerëve joqeveritarë. Kapacitetet e donatorëve lidhur me çështjet gjinore janë gjithashtu të pamjaftueshme në nivelin lokal dhe çojnë në mungesë koherence dhe vazhdimësie, veçanërisht në nivel programesh, pasi qeveria nuk e udhëheqë agjendën. Përafrimi i pamjaftueshëm i NZZH-së me hartimin e politikave gjinore dhe programore kombëtare gjithashtu rezulton nga shkëmbimi i dobët i të dhënave – përafrimi nuk mund të ndodhë duke pasur mungesë komunikimi.

Punimi përfundon me një seri rekomandimesh të gjera por praktike për ta rritur përafrimin. Duhet të bëhen përpjekje për t'u siguruar që Programi i ri i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) të shërbejë si një spirancë e fortë për planifikimin dhe programimin e politikave në të ardhmen përmes mekanizmave më të mirë operacional dhe një roli më pro aktiv nga ABGJ-ja. Punimi gjithashtu sugjeron mënyrat me të cilat ABGJ-ja mund të luajë rol shumë më të fortë në dialogun e politikave midis qeverisë dhe donatorëve në lidhje me strategjitë e ndihmës zhvillimore në përgjithësi. Ai gjithashtu thekson përpjekjet për t'i forcuar kapacitetet për programim dhe zhvillim të projekteve, veçanërisht në lidhje me IPA-n, si dhe menaxhimin e programit, ndoshta përmes një njësie të specializuar. Para se të konsiderohet ndonjë përmirësim në përafrim, qeveria e Kosovës dhe komuniteti i donatorëve duhet të përmirësojnë disponueshmërinë e të dhënave për NZZH-në me relevancë gjinore, duke përfshirë shënuesit gjinorë në PMN dhe duke zbërthyer dhe raportuar të dhënat gjinore nga projektet. E fundit por jo më pak e rëndësishme, punimi shqyrton mënyrat në të cilat donatorët mund të punojë në kapacitetet e tyre për planifikim dhe programim gjinor dhe të respektojë më shumë pronësinë e vendit.

2. Fushëveprimi dhe metodologjia

Qëllimi i këtij vlerësimi është të shihet shkalla në të cilën Ndihma Zyrtare për Zhvillim (NZZH) që synon të mbështesë barazinë gjinore në Kosovë u përafrua me agjendën e politikave të Kosovës dhe kornizën institucionale për periudhën 2015-2018, si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësime. Duke theksuar "përafrimin" (siç përcaktohet nga Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës) qëllimi këtu nuk është të vlerësohet cilësia e politikave kombëtare ose e kornizave apo cilësia e punës që po bëhet nga donatorët dhe agjencitë zhvillimore për temën e barazisë gjinore. Përkundrazi, përafrimi shikon më shumë në bashkëveprimin midis asaj që qeveria mendon se duhet të bëhet dhe se si duhet të bëhet, me atë që po bëjnë donatorët në lidhje me çështjen dhe si po e bëjnë atë. Përkatesisht, pyetjet kryesore janë: sa mirë po funksionojnë këta të bashkërenduar dhe në çfarë shkalle ka një pronësi vendore? Si i tillë, ky vlerësim nuk ka për qëllim të kuptojë se kush ka të drejtë dhe kush ka gabuar në kuptimin e përmbajtjes së kornizave të politikave dhe qëllimeve të tyre përfundimtare, por përkundrazi të kuptojë dinamikën që rrit ose parandalon procesin e përafrimit. Përgjigjet në këto pyetje synojnë ta ndihmojnë qeverinë dhe komunitetin e donatorëve për ta përmirësuar efektivitetin e ndihmës.

Vlerësimi përdori një kombinim të burimeve primare sasiore dhe cilësore për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve përmes një procesi me tri shtresa. Së pari, pas një takimi fillestar me akterët, vlerësimi filloi me shqyrtim dokumentesh në zyrë të politikave përkatëse kombëtare për barazinë gjinore për periudhën përkatëse 2015-2018 (siç përcaktohet nga Agjencia për Barazi Gjinore) si dhe të dokumenteve strategjike të donatorëve dhe agjencive zhvillimore. Së dyti, vlerësimi përdori të dhënat zyrtare të NZZH-së nga baza e të dhënave e Platformës për Menaxhimin e Ndihmës të hostuar në Ministrinë e Integrimit Evropian (MIE) për: a) t'i identifikuar donatorët kryesorë dhe partnerët zhvillimorë sipas vëllimit në fushën e barazisë gjinore për përzgjedhje në intervista; b) të ofruar njohuri kuptimplote sasiore që kanë rëndësi për ta vlerësuar gjendjen e përafrimit. Së treti, intervistat gjysmë të strukturuar u kryen me dy institucione qeveritare dhe nëntë partnerë zhvillimorë për të marrë njohuri kuptimplote cilësore mbi dinamikën.

Lloji i burimit	Detajet
Dokumentet e politikave kornizë (2015-2018)	<u>Strategjitë qeveritare / ligjet</u> Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ) Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2016-2020) Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë (2015-2018) <u>Strategjitë shumëpalëshe të partnerëve</u> BE (IPA), Strategjia e Bankës Botërore për vendin, UN Women, UNDP, USAID, GIZ, SIDA, NORAD, ADA, Luksemburgu, Holanda, Ambasada e Finlandës, MB, Ambasada e Zvicrës
Statistikat për NZZH-në	Platforma për Menaxhimin e Ndihmës (Ministria e Integrimit Evropian)
Korniza konceptuale	Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës

11 intervistat gjysmë të strukturuar:	<u>Qeveria (2)</u> Agjencia për Barazi Gjinore, MIE (DAZH) <u>Partnerët zhvillimor (9)</u> UN Women, BERZH, USAID, Ambasada e MB-së, Ambasada e Holandës, ADA, Ambasada e Finlandës, SIDA, Ambasada e Norvegjisë
--	--

Gjëja kryesore për t'u pasur parasysh: 1870 përshkrime projektsh nga periudha 2015-2018 u rishikuan në bazën e të dhënave të PMN-së për t'i identifikuar dhe kategorizuar projektet me relevancë gjinore. NZZH-ja që merr Kosova raportohet rregullisht nga partnerët zhvillimorë në PMN, por është e vështirë të identifikohen projektet me relenavcë gjinore. PMN-ja mundëson ndarjen e NZZH-së nëpër variabla të ndryshme siç janë donatori, lloji i përfituesit, lloji i ndihmës (grant ose projekt, etj.) si dhe sektori. Sidoqoftë, klasifikimet sektorit nga OBZHE/KNZH nuk kanë gjininë si sektor të veçantë – fuqizimi i grave është një nënsektor brenda sektorit të "Qeverisë dhe Shoqërisë Civile". Pas rishikimit preliminar të grupit të të dhënave u vu në pah se shumë projekte që kishin objektiva dhe aktivitete me relevancë gjinore nuk u konsideruan se kishin ndonjë klasifikim gjinor, por u shpërndanë në sektorë të ndryshëm si punësimi, shëndetësia ose të drejtat e njeriut. Prandaj, për qëllimet e këtij vlerësimi, përshkrimet e projektit të 1870 projekteve aktive në periudhën midis viteve 2015 dhe 2018 u rishikuan në mënyrë manuale. Nga ky rishikim u konstatua se 137 projekte (ose vetëm 7.3 për qind) kishin relevancë gjinore dhe u sinjalizuan me flamur si dhe u dhanë klasifikime të mëtejshme në bazën e të dhënave.

Vlerësimi ka dy kufizime kryesore metodologjike që duhet të merren parasysh. Së pari, shumica e analizave mbështeten në të dhëna sasiore nga grupi i të dhënave të PMN-së dhe klasifikimin subjektiv të projekteve me relevancë gjinore nga përshkrimet e projekteve. Përshkrimet dhe qëllimet e projektit në disa raste nuk janë të qarta në shpjegimin se çfarë saktësisht bën projekti. Për më tepër, ekziston një mospërputhje e konsiderueshme sa i përket nivelit të detajeve që ofrohen. Disa projekte tematike bëjnë gjëra të shumëfishta dhe kanë gjininë si komponent, por bazuar në përshkrimin është e paqartë se cili është fushëveprimi i tyre si dhe pjesa e atij komponenti brenda shumës totale të projektit. Andaj, gjetjet dhe supozimet analitike që formojnë këtë raport janë të sakta për aq sa ishin të qarta dhe të sakta përshkrimet e projektit të futura nga donatorët dhe partnerët zhvillimorë. Për këtë qëllim, ne kemi vërejtur nga burime tjera projekte tjera të zbatuara në këtë kohë që kishin relevancë gjinore, por që nuk u gjetën në bazën e të dhënave të PMN. Sidoqoftë, për qëllime të konsistencës metodologjike, këto projekte nuk janë vendosur në bazën e të dhënave ose nuk janë përfshirë në vlerësim. Kufizimi i dytë metodologjik është fakti se një numër i konsiderueshëm i intervistave cilësore janë realizuar me përfaqësues të donatorëve dhe agjencive zhvillimore të cilët nuk kishin memorie të mjaftueshme institucionale për periudhën përkatëse, ose ishin pika fokale gjinore por nuk kishin shumë njohuri për kornizën më të gjerë të politikave dhe peizazhin. Prandaj, gjetjet e këtij vlerësimi janë të sakta për aq sa subjektet e intervistuar ishin në gjendje t'i kujtojnë zhvillimet në periudhën 2015-2018 ose të kenë njohuri për kontekstin.

Ky vlerësim ndjek një strukturë dhe rrjedhë të qartë duke filluar nga pyetjet themelore e deri tek analizat më specifike. Së pari, punimi përshkruan kornizën konceptuale për analizë dhe përpiket të artikulojë se çfarë saktësisht jemi duke matur kur përdorim termin "përafrim" dhe cilët janë

parametrat që i shikojmë. Këtu së pari përshkruajmë dimensionet e përafrimit të NZZH-së; elaborojmë kornizën institucionale dhe të politikave të Kosovës në kuptim të barazisë gjinore dhe, ofrojmë statistika preliminare për NZZH-në që lidhet me gjininë. Së dyti, duke përdorur të dhëna nga baza e të dhënave e PMN-së që janë kategorizuar në mënyrë specifike për qëllimet e këtij vlerësimi, punimi prova statistikore për shkallën në të cilën ka pasur një përafrim ndërmjet prioritetëve të politikave të qeverisë së Kosovës dhe projekteve të zbatuara nga donatorët dhe nga agjencitë zhvillimore. E fundit por jo më pak e rëndësishme, përmes njohurive kuptimplote nga intervistat me agjencitë qeveritare dhe donatorët/partnerët zhvillimore, vlerësimi përpiqet të kuptojë dinamikën që mundësoi ose parandaloi një shkallë më të lartë të përafrimit.

3. Korniza konceptuale për analizë: çfarë po matim?

Analiza e përafrimit të ndihmës për zhvillim në temën gjinore duhet të fillojë me një kuptim të variablave që po e shikojmë dhe krijimin e një kornize analitike. Për të kuptuar se si mund të matim nivelin e përafrimit, para së gjithash duhet të përcaktojmë se çfarë do të thotë përafrimi dhe cilat janë dimensionet e tij specifike të analizës. Këto dimensione do të shërbejnë si bazë mbi të cilën ne mund të përcaktojmë shkallën në të cilën ka pasur një përafrim apo jo ndërmjet donatorëve dhe qeverisë së Kosovës. Së dyti, ne duhet të shohim se cila ishte korniza institucionale dhe e politikave në Kosovë gjatë kësaj periudhe, veçanërisht pasi ka të bëjë me planifikimin e politikave kombëtare dhe sektoriale, menaxhimin dhe koordinimin e donatorëve. Konkretisht, cilat ishin strategjitë, proceset dhe strategjitë që rregullojnë fushën e politikave? Pikërisht brenda kësaj kornize është dashur të ndodhë përafrimi. Së treti, ne duhet të shohim në mënyrë specifike kornizën institucionale dhe të politikave që është përgjegjëse për gjininë. E fundit por jo më pak e rëndësishme, ne duhet të shohim rrjedhat e NZZH-së dhe të përpiqemi të kapim dhe të klasifikojmë ato projekte të rëndësishme për barazinë gjinore, pasi ato do të vlerësohen për përafrim.

3.1 Dimensionet e përafrimit të NZZH-së

Përafrimi i donatorëve është pjesë thelbësore e Deklaratës së Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës të rënë dakord në vitin 2005. Rreth 60 vende partnere, 30 vende donatore dhe 30 agjenci të tjera zhvillimore janë zotuar që të ndërmarrin veprimet specifike për të rritur efektivitetin e ndihmës. Këto veprime përfshijnë rritjen e pronësisë nga vendet marrëse, harmonizimin, përafrimin, menaxhimin e rezultateve të zhvillimit dhe përgjegjshmërinë e ndërsjellë për përdorimin e ndihmës. Sa i përket përafrimit, Deklarata e Parisit merr parasysh katër dimensione (të ilustruara në Figurën 1).



Figura 1: Dimensionet e përafrimit të NZZH-së

Konkretisht, nocioni i përafrimit nënkupton që:ⁱ

- Donatorët duhet të nxjerrin strategjitë, programet ose grantet e tyre nga prioritetet vendore (d.m.th. strategjitë kombëtare ose sektoriale), të angazhohen në dialog politikash me vendin partner dhe të lidhen me një kornizë të vetme të kushteve dhe/ose grupi treguesish të menaxhueshëm.
- Donatorët duhet të përdorin institucionet dhe sistemet e vendit nëse ka siguri se ndihma do të përdoret për qëllimet e dakorduara dhe kornizat e dakorduara reciprokisht.
- Partnerët duhet të forcojnë kapacitetin zhvillimor me mbështetje nga donatorët, përfshirë planifikimin, menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve.
- Donatorët dhe partnerët duhet të përdorin standarde dhe procese të dakorduara reciprokisht për të kryer diagnostikimin, për të zhvilluar reforma të qëndrueshme dhe për ta monitoruar zbatimin, si dhe duhet të zotojnë burime të mjaftueshme për të përkrahur dhe mbështetur reformat e prokurimit afatmesme dhe afatgjata.

3.2 Konteksti vendor: Korniza e politikave të Kosovës

Cilat ishin prioritetet vendore gjinore për të cilat donatorët dhe partnerët duhej të përafroheshin? A kishte ndonjë kornizë politikash të krijuar nga qeveria gjatë kësaj periudhe që ata mund ta përdornin si bazë për intervenimet për zhvillim? Normalisht, prioritetet e politikave në kuptim gjinor në Kosovë janë (sipas Ligjit për Barazi Gjinore) të përshkruara përmes Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ). Sidoqoftë, periudha e PKBGJ-së së fundit ka skaduar (ajo ka mbuluar periudhën 2008-2013) ndërsa një e re ka qenë në proces të zhvillimit.

Prandaj, në konsultim me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) ka përcaktuar që gjatë kësaj periudhe dokumentet udhëzuese/prioritare në Kosovë kanë qenë prioritetet përkatëse gjinore që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) (2016-2020)ⁱⁱ; Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (SKMDHF) 2016-2020, Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Njerëzve në Kosovë (SKTNJ) 2015-2018; dhe Ligji për Barazi Gjinore (LBGJ) (2015). Për qëllime të thjeshtësisë dhe vlerësimit të përafrimit, këto dokumente kornizë mund të identifikojnë pesë fushat prioritare të qeverisë së Kosovës gjatë kësaj periudhe (shiko Figurën 2). Prioritetet nuk janë radhitur në ndonjë mënyrë të veçantë bazuar në nivelin e priorizimit të tyre. Në vend të kësaj, ne vetëm theksojmë se këto çështje ishin prioritet gjatë kësaj periudhe.

Tabela 1: Dokumentet e kornizës ligjore dhe të politikave të Kosovës për barazinë gjinore

DOKUMENTI KORNIZË	PËRMBAJTJA
Kushtetuta e Kosovës	Më konkretisht, neni 7.1 përcakton rendin kushtetues duke u bazuar në disa parime, përfshirë barazinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin. Për më tepër, neni 22 siguron zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të një liste të rezolutave dhe instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
Ligji për Barazi Gjinore (2015)	LBGJ parashikon masa të ndryshme për të ndaluar diskriminimin gjinor dhe për të siguruar përfaqësim të barabartë; përmes pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje dhe jetën publike dhe

	veprimeve afirmative në rekrutimin, punësimin dhe promovimin e grave për të arritur barazinë gjinore. Ligji kërkon zbatimin e analizës gjinore dhe vlerësimin e ndikimit gjinor në të gjitha kornizat e politikave të vendit, qasje të barabartë dhe alokimin e burimeve të vendit sipas parimeve të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGJ) si obligues për të gjitha organizatat buxhetore në planifikimin e tyre financiar dhe alokimin e burimeve. Ligji kërkon që të gjitha subjektet publike dhe private të Kosovës të mbledhin dhe të paraqesin të dhëna të ndara sipas gjinisë. LBGJ bën thirrje për parandalimin e stereotipave gjinorë në tekste shkollore dhe në media dhe për promovimin e vlerave të barazisë gjinore në të gjithë jetën shoqërore të Kosovës.
Programi i Kosovës për Barazi Gjinore	PKBGJ është i vetmi program zhvillimi që kërkohet me ligj që të hartohet, ndërsa të gjitha kornizat e tjera drejtohen kryesisht nga programet politike të qeverive ose nga procesi i integritetit evropian. Përderisa nuk kishte asnjë dokument në vetvete të PKBGJ-së gjatë kësaj periudhe mes viteve 2017-2019, Agjencia, me mbështetjen e një projekti të financuar nga SIDA, drejtoi procesin e hartimit të PKBGJ-së së re.
Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)	Paraqet 34 "prioritete të prioriteteve" ose masa të reformës strukturore nga strategjitë tjera sektoriale. Sipas vlerësimit të ABGJ-së, dy nga 34 prioritetet janë prioritete që lidhen me gjininë.
Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (SKMDHF) 2016-2020	Synon të sigurojë: 1) Parandalimin dhe ngritjen e vetëdijes duke ngritur kapacitetet e shërbimeve të kujdesit parësor, duke inkurajuar viktimat të raportojnë raste dhe duke rritur vetëdijen sociale. 2) Mbrojtjen e viktimave përmes mekanizmave më të mirë të koordinimit ndërmjet nivelit lokal, nivelit qendror dhe shoqërisë civile. 3) Legjislacion të përmirësuar për trajtim më efikas të çështjeve përmes trajnimit të hetuesve, punëtorëve socialë, prokurorëve ose gjyqtarëve. 4) Rehabilitim dhe riintegrim të viktimave.
Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz në Kosovë (2015-2018)	Synon: 1) Përmirësimin e parandalimit përmes informacionit, ndërgjegjësimin dhe arsimimit; 2) Forcimin e sistemit të identifikimit, mbrojtjes, ndihmës dhe riintegritetit të viktimave; 3) Rritjen e ndjekjes penale efikase dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe vendor.

Figura 2: Gjashtë fusha prioritare të politikave të barazisë gjinore për Kosovën gjatë 2015-2018

Prioriteti 1: Ligji për Barazi Gjinore

Prioriteti 2: Ligji kundër Diskriminimit

Prioriteti 3: Dhuna në familje (Strategjia)

Prioriteti 4: Antitrafikimi (Strategjia)

Prioriteti 5: Qasje e shtuar në arsimin parashkollor (SZHK)

Prioriteti 6: Të drejtat pronësore të grave (SKZH)

3.3 Konteksti vendor: Korniza institucionale

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) është e mandatuar përmes Ligjit për Barazi Gjinore që të shërbejë si institucion kryesor i qeverisë qendrore përgjegjës për hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave gjinore. ABGJ është e vendosur në Zyrën e Kryeministrit dhe luan role të shumëfishta në vlerësimin e gjendjes së barazisë gjinore, ngritjen e vetëdijes, punën me organet e tjera qeveritare për të përfshirë gjininë në përgatitjen e ligjeve, strategjive dhe programeve, etj – dhe është përgjegjëse për hartimin dhe menaxhimin e PKBGJ-së. Meqenëse gjatë kësaj periudhe PKBGJ ishte në përgatitje e sipër, ABGJ-ja gjatë kësaj periudhe luajti rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të LBGJ-së të punoj me Zyrtarët për Barazi Gjinore (ZBGJ-të) në ministritë e linjës dhe komunat për të siguruar zbatimin e LBGJ-së në të gjithë sektorët dhe nivelet. Që nga viti 2015, **Ministria e Financave** gjithashtu luan një rol ku - Qarkorja buxhetore vjetore e lëshuar nga Ministria e Financave kërkon që të gjitha subjektet publike t'i zbatojnë parimet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në procesin e tyre të planifikimit të buxhetit vjetor. Një organ tjetër kryesor qendror është **Zyra e Planifikimit Strategjik (ZPS) në ZKM** e cila është përgjegjëse për koordinimin e procesit të planifikimit strategjik, duke filluar nga SKZH, Programi i Reformës Ekonomike, e deri te programi qeveritar dhe strategjitë sektoriale.

Ekzistojnë edhe organe dhe mekanizma të tjerë kryesorë që punojnë në fusha të veçanta të fokusit. Sa i përket dhunës në familje, gjatë kësaj periudhe ka qenë Sekretariati Ndërministror për Dhunën në Familje i udhëhequr nga një Koordinator Kombëtar (Zëvendësministër i Drejtësisë), mandati i të cilit ishte mbikëqyrja e zbatimit të SKMDHF-së. Ekziston gjithashtu Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i cili vepron si raportues në vlerësimin e trafikimit dhe masave, mbështetur nga një Sekretariat që monitoron strategjinë kundër trafikimit, i cili është i vendosur në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Në drejtim të avancimit të të drejtave pronësore të grave, Ministria e Drejtësisë është caktuar në SKZH si përgjegjëse për të zbatuar masën përkatëse të SKZH-së dhe është gjithashtu përgjegjëse për të zbatuar Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore, e cila përcakton masat specifike për çështjet pronësore të grave.ⁱⁱⁱ Zgjerimi i

shërbimeve parashkollare është nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit (MASHT) dhe drejtorive komunale të arsimit. Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe grupe joformale si Grupi për Koordinim të Sigurisë dhe Gjinisë (GKSGJ), i përbërë nga institucione qeveritare, donatorë, agjenci zhvillimore, të cilat janë fokusuar kryesisht në dhunën në familje dhe qasjen në drejtësi.

Sa i përket koordinimit të donatorëve, Ministria e Integritit Evropian (MIE) ka një mandat horizontal për koordinimin e donatorëve dhe shërben si Sekretariat i Forumit të Nivelit të Lartë dhe Grupeve Punuese Sektoriale. MIE administron Platformën për Menaxhimin e Ndhmës (PMN), një sistem online i menaxhimit të të dhënave që funksionon që nga viti 2009, ku secili donator mund të regjistrojë informacione për zotimet e financimit dhe disbursimin në intervale periodike. Të dhënat e PMN-së sigurojnë një përmbledhje të qartë të ndihmës së jashtme në krahasim me prioritetet zhvillimore të Kosovës. Sipas Rregullores së Qeverisë së Kosovës nr. 09/2015^{iv}, organi më i lartë vendimmarrës përgjegjës për koordinimin e ndihmës së donatorëve është Forumi i Nivelit të Lartë i kryesuar nga Kryeministri. Forumi i Nivelit të Lartë është përgjegjës për të mbikëqyrur rrjedhën e ndihmës së jashtme në Kosovë, për t'i identifikuar prioritetet kryesore për ndihmën e jashtme, për ta rishikuar përparimin e ndihmës për zhvillim dhe për ta monitorojë efektivitetin e përgjithshëm të ndihmës së jashtme bazuar në parimet e menaxhimit të ndihmës të përcaktuara në Deklaratën e Parisit të vitit 2005. Forumi i Nivelit të Lartë mbikëqyr aktivitetet e disa trupave punues të quajtur Grupet Punuese Sektoriale të cilat janë krijuar për të harmonizuar ndihmën e donatorëve me prioritetet kombëtare të Kosovës, duke monitoruar ndihmën bazuar në treguesit e sektorit dhe duke përafruar strategjitë dhe politikat sektoriale kombëtare me ndihmën e jashtme. Secili Grup Punues Sektorial mund të krijojë një ose më shumë grupe punuese nënsektoriale që përqendrohen në fusha specifike të punës. Nuk ka ndonjë grup punues sektorial ose nën-sektorial për barazinë gjinore meqë kjo trajtohet më shumë si çështje ndërlidhëse (nëse mbahen takime të tilla).

Për më tepër, MIE prodhon raporte vjetore mbi rrjedhat e NZZH-së dhe bën një vlerësim themelor të përafrimit me prioritetet e qeverisë. Raportet vjetore të MIE-së sigurojnë informata mbi performancën financiare të donatorëve gjatë vitit; zotimet dhe disbursimet sipas sektorëve të OBZHE/KNZH; siguron informata për disbursimin sipas komunave; si dhe siguron informata për prioritetet e qeverisë së Kosovës me planifikimin e donatorëve. Raportet rendisin prioritetet e bazuara në SKZH, Agjendën për Reforma Evropiane dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) dhe identifikojnë pesë fusha të gjera prioritare. Më pas grupon disa sektorë të OBZHE/KNZH në përputhje me pesë fushat e gjera prioritare për të siguruar shumat e dhëna për secilën fushë të politikave.

MIE ka një kornizë të qëndrueshme institucionale për koordinim me ministritë e linjës si dhe me Zyrën e BE-së në programimin vjetor të veprimeve të IPA-s. Gjatë fazës së përgatitjes, strategjitë kombëtare sektoriale dhe nevojat e ndihmës së menjëhershme përkthehen në një Dokument të Planifikimit Sektorial (DPS) të cilin MIE, institucionet përfituese dhe BE-ja e zhvillojnë në bashkëpunim të ngushtë. Një dokument kryesor që drejton zhvillimin e këtyre dokumenteve është Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit i cili i jep përparësi masave që lidhen me pranimin e Kosovës në BE. Këto dokumente elaborojnë një logjikë intervenuese koherente që drejton zhvillimin e projekteve të financuara nga BE-ja. Ato gjithashtu vendosin kornizën e përgjithshme të monitorimit. DPS-të pastaj konsultohen

me BE-në. Bazuar në rezultatet e atyre konsultimeve, DPS-të çojnë në përgatitjen e një ose disa Programeve të Veprimit për çdo DPS.

3.4 Donatorët: NZZH e fokusuar në barazinë gjinore

Kosova mori gjithsej 695 milionë euro NZZH gjatë periudhës 2015-2018, por është e vështirë të përcaktohet se cila pjesë e asaj NZZH-je fokusohet në gjininë. Të grupi i të dhënave të PMN-së i klasifikon të gjitha projektet sipas sektorëve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE). OBZHE aktualisht identifikon 25 sektorë, ku asnjë prej tyre nuk ka fokus specifik mbi gjininë, si dhe shumë nën sektorë të tjerë. Kjo e bën të pamundur krijimin e një liste automatike të projekteve me relevancë gjinore. Një rishikim i listës së projekteve në një fletë Exceli të PMN-së tregon se disa projekte gjinore klasifikohen si projekte të *Qeverisë dhe Shoqërisë Civile (Kodi 150)* dhe nënsektorët e tyre janë *Organizata dhe Institucione të Grave për Barazi (Kodi 15170)* ose *Të Drejtat e Njeriut (Kodi 15160)*. Sidoqoftë, shumë projekte të tjera nuk përdorin sektorë ose nënsektorë që do të sugjerorin relevancë gjinore, megjithatë kanë relevancë të fortë gjinore bazuar në përshkrimin e projektit të tyre.

Mënyra e vetme për t'i identifikuar projektet me relevancë gjinore ishte të klasifikoheshin të gjitha projektet në grupin e të dhënave të PMN-së që kishin shënues gjinor. Komiteti i Përhershëm i ndër-agjencish të OKB-së zhvilloi shënuesin gjinor si mjet që "kodon, në një shkallë 0-3, nëse një projekt humanitar është dizajnuar aq mirë sa për të siguruar që gratë/vajzat dhe burrat/djemtë do të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ai ose që do të avancojë barazinë gjinore në ndonjë mënyrë tjetër. Nëse projekti ka potencialin të kontribuojë në barazinë gjinore, shënuesi parashikon nëse rezultatet kanë të ngjarë të jenë të kufizuara apo domethënëse.”^v Shënuesit gjinorë dhe rezultatet e tyre përkatëse janë sqaruar më poshtë.

Tabela 2: Përshkrimet e shënuesve gjinorë

Shënuesit gjinorë	Përshkrimi
0	Nuk ka shenja se çështjet gjinore janë konsideruar në dizajnimin e projektit. Ekziston rreziku që projekti do të ushqejë pa dashje pabarazitë gjinore ekzistuese ose do t'i thellojë ato.
1	Projekti është dizajnuar për të kontribuar në një mënyrë të kufizuar në barazinë gjinore. Dizajni ka mundur të jetë më i fortë dhe të avancojë barazinë gjinore më shumë. a) Vlerësimi i nevojave i projektit përfshin një analizë gjinore e cila nuk reflektohet në mënyrë të konsiderueshme në aktivitete dhe rezultate OSE b) Të paktën një aktivitet dhe rezultat synon të avancojë barazinë gjinore, por kjo nuk mbështetet nga vlerësimi i nevojave.
2	Ai është dizajnuar që të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në barazinë gjinore. Nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe burrave/djemve janë analizuar dhe integruar mirë në aktivitete dhe rezultate.
3	Qëllimi kryesor i projektit është avancimi i barazisë gjinore. I gjithë projekti ose: a) ndihmon gratë apo burrat, vajzat apo djemtë që vuajnë nga diskriminimi duke krijuar kushte më të barabarta OSE b) përqendron të gjitha aktivitetet në ndërtimin e shërbimeve specifike gjinore ose në marrëdhënie më të barabarta midis grave dhe burrave.

Përmes një vlerësimi të detajuar të përshkrimeve të projekteve ne kemi qenë në gjendje t'i identifikojmë dhe klasifikojmë ato me relevancë gjinore sipas shënuesve gjinorë. Nga gjithsej 1870 projekte të shqyrtuara, 137 projekte kishin relevancë gjinore. Nga gjithsej 695 milion euro NZZH të disbursuara gjatë periudhës 2015-2018, 49.4 milionë euro rezulton se kanë relevancë gjinore, ndërsa një shumë e konsiderueshme prej 15 milionë eurove kishin shënuesin gjinor 3, që do të thotë se ishin dedikuar për projekte që kishin fokus kryesor gjininë (Figura 3). Për sa i përket vëllimit të përgjithshëm të NZZH-së, NZZH-ja me relevancë gjinore përfaqësonte 7 për qind të NZZH-së totale (Figura 4). Nga kjo NZZH me relevancë gjinore, 27 për qind (104 projekte në total) kishin shënuesin gjinor 3 (shiko Figurën 5). Këto projekte, të fokusuar kryesisht në pabarazinë gjinore, zakonisht ishin projekte më të vogla në madhësi duke u fokusuar në mënyrë specifike në çështje të tilla si dhuna në familje ose antitrafik -imi ose fuqizimi i grave.

Sidoqoftë, pjesa më e madhe e projekteve përkatëse gjinore kishte shënuesin gjinor 2. Në total, në këtë kategori ishin 19 projekte, ose 42 për qind e NZZH-së me relevancë gjinore. Këto projekte ishin më të vogla në numër, por shumë më të mëdha për sa i përket vëllimit të NZZH-së, sepse ato zakonisht ishin programe më të mëdha tematike që fokusoheshin në çështje të tilla si punësimi, aftësitë, zhvillimi i biznesit. Konkretisht, këto ishin programe tematike të sinjalizuara të zbatuara nga donatorë si USAID, SDC ose huadhënës si BERZH-i që kryesisht kishin fokus ekonomik (ose në rastin e USAID, një program kryesor për të drejtat pronësore që kishte një komponent të fortë gjinor).

Figura 3: NZZH në Kosovë (2015-2008) sipas relevancës gjinore (në euro)




Figura 4: NZZH-ja me relevance gjinore si një pjesë e NZZH së përgjithshme (% e shumës totale të NZZH)





Figura 5: NZZH me relevancë gjinore sipas shënuesit gjinor (% e vëllimit të projektit)



Përmes një vështrimi më të afërt është e mundur të identifikohen dhe klasifikohen vendet kryesore donatore sipas totalit të NZZH-së me relevancë gjinore, sipas shënuesit gjinor dhe sipas përqindjes së NZZH-së gjinore brenda totalit të NZZH-së. Tabela 3 jep një listë të donatorëve sipas shumave të përgjithshme të NZZH-së me relevancë gjinore gjatë kësaj periudhe, si dhe NZZH-në sipas shënuesit gjinor. Në shikim të parë duket se SDC dhe USAID janë donatorët më të mëdhenj të barazisë gjinore (më shumë se 10 milionë NZZH me relevancë gjinore gjatë kësaj periudhe). Por ekziston një paralajmërim për këtë – asnjë prej programeve të tyre nuk klasifikohen me Shënuesin Gjinor 3 – shumica e programeve të tyre marrin Shënuesin Gjinor 2, konkretisht dizajnohen për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në barazinë gjinore por nuk e kanë gjininë si prioritet. Konkretisht, këto ishin projekte ku nevojat e ndryshme të grave/vajzave dhe

burrave/djemve janë analizuar dhe integruar mirë në aktivitete dhe në rezultate. Ato janë projekte tematike që fokusohen në krijimin e vendeve të punës/tregun e punës ose sektorin e drejtësisë, por që kanë një komponent të fortë gjinor.

Tabela 3: NZZH-ja sipas shënuesve gjinorë dhe donatorëve (2015-2018), në euro

Donatori	NZZH-ja me relevancë gjinore	Shënuesi gjinor 3	Shënuesi gjinor 2	Shënuesi gjinor 1	TOTALI i NZZH-së	NZZH-ja gjinore si % e totalit të NZZH-së
SDC	10,551,785	0	6,383,844	4,167,940	54,318,878	19%
USAID	10,364,316	0	10,144,188	220,128	120,732,773	9%
BE	8,685,682	3,302,112	848,391	4,535,179	261,030,211	3%
BERZH	5,000,000	5,000,000	0	0	25,284,600	20%
Suedia	3,882,404	1,054,597	0	2,827,807	39,703,971	10%
Gjermania	2,415,262	250,000	1,760,262	405,000	117,106,988	2%
Austria	1,804,564	527,800	1,088,842	187,922	14,697,669	12%
Finlanda	1,775,380	1,057,178	0	718,202	4,619,733	38%
Holanda	898,769	678,912	123,078	96,779	2,664,382	34%
Luksemburgu	882,773	882,773	0	0	10,178,331	9%
MB	857,879	689,349	168,530	0	21,419,905	4%
UNFPA	521,219	69,427	451,793	0	1,129,438	46%
Norvegjia	471,553	436,281	0	35,271	2,548,218	19%
UNMIK	419,126	419,126	0	0	869,497	48%
UN Women	406,615	406,615	0	0	406,615	100%
UNDP	201,436	3,145	188,738	9,554	2,090,415	10%
Danimarka	152,730	152,730	0	0	4,036,377	4%
Japonia	71,758	71,758	0	0	8,448,664	1%
UNICEF	62,123	44,373	17,749	0	4,706,161	1%
TOTALI	49,425,374	15,046,176	21,175,415	13,203,782	695,992,826	

Tabela 4: Shuma totale e projekteve të NZZH-së me Shënuesin Gjinator 3 gjatë periudhës 2015-2018 (në euro)

Donatori	Shënuesi gjinator 3
BERZH	5,000,000
BE	3,302,112
Finlanda	1,057,178
Suedia	1,054,597
Luksemburgu	882,773
Austria	715,722
MB	689,349
Holanda	678,912
Norvegjia	436,281
UNMIK	419,126
UN Women	406,615

Disa donatorë mund të mos kenë portofol të madh të NZZH-së në Kosovë, por projektet që fokusohen posaçërisht në barazinë gjinore marrin një pjesë të konsiderueshme të tij. Tabela 5 ilustron donatorët që i japin përparësi gjinisë më së shumti brenda portofolit të tyre (pavarësisht nga madhësia e NZZH-së totale). Përkatësisht, ajo ilustron pjesën e projekteve me Shënuesin Gjinator 3 (fokusi kryesor në gjini) si përqindje e NZZH-së totale. Llojet e donatorëve që ishin relativisht të vegjël por kishin intensitet më të lartë se intensiteti mesatar i projekteve me prioritet gjininë përfshinin Holandën, Finlandën dhe Norvegjinë. Natyrisht, për shkak të mandatit të saj, UN Women ndonëse me një portofol të jo të madh të përgjithshëm të NZZH-së gjatë kësaj periudhe (406,616 euro), programet e saj kanë 100 % e tij është me relevancë gjinore. Një kategori tjetër e donatorëve kanë programe të mëdha por prioritojnë gjininë si çështje e ndërlidhur. Tabela tjetër (Tabela 6) më poshtë ilustron 5 donatorët kryesorë që kanë fokus të fortë në gjininë (Shënuesi Gjinator 2) por kryesisht si çështje ndërlidhëse përmes projekteve të mëdha tematike si punësimi ose sundimi i ligjit. Rastësisht, donatorët si SDC dhe USAID kanë kontribute shumë të konsiderueshme.

Tabela 5: NZZH me shënuesin gjinor 3 si përqindje e NZZH-së totale

Donatori	Përqindja
UN Women	100%
UNMIK	48%
Holanda	25%
Finlanda	25%
BERZH	20%
Norvegjia	17%
UNFPA	6%
Austria	5%
Danimarka	4%
Suedia	3%
MB	3%
BE	1%
Gjermania	0%

Tabela 6: NZZH me shënuesin gjinor 2 si përqindje e NZZH-së totale + shuma totale

Donatori	Përqindja	Totali
SDC	12%	6,383,844
USAID	8%	10,144,188
UNDP	9%	188,738
Austria	7%	1,088,842
Holanda	5%	123,078

4. Vlerësimi i përafrimit: çfarë thonë statistikat?

Ky seksion i punimit zhytet më thellësisht në pyetjen kryesore të vlerësimit: sa ishte përafruar NZZH-ja me relevancë gjinore me prioritetet dhe sistemet e politikave të qeverisë? Kjo bëhet para së gjithash duke u fokusuar në dimensionin e politikave – domethënë, duke shikuar të dhënat e PMN-së dhe duke rishqyrtuar shkallën në të cilën ekziston përafrim ndërmjet projekteve me relevancë gjinore dhe prioritetet e politikave të qeverisë të përcaktuara më lart. Së dyti, përmes njohurive kuptimplote të marra nga intervistat cilësore bëhet një vlerësim sa i përket arsyes prapa zgjedhjeve të donatorëve për intervenime dhe se ku ka boshllëqe ose probleme. Duhet të theksohet se të dhënat sasiore duhet të shqyrtohen me kujdes gjatë supozimeve rreth përafrimit. Vetëm pse projektet specifike (siç përshkruhet në bazën e të dhënave të PMN-së sipas donatorëve) përfshijnë një temë të veçantë që është prioritet për qeverinë e Kosovës, nuk do të thotë se ato e përfshijnë atë në mënyrën specifike në të cilën qeveria mendon se çështja duhet të përfshihet.

4.1. Përafrimi me fushat prioritare

Informatat e nxjerra nga baza e të dhënave të PMN-së mund të përdoren për të siguruar disa indikacione sasiore se sa ishte përafruar NZZH-ja me fokus në gjini me prioritetet e politikave të qeverisë gjatë kësaj periudhe të vlerësimit. Projektet përkatëse gjinore të listuara në grupin e të dhënave të PMN-së u shqyrtuan edhe një herë në përshkruesit e projekteve (krahas shqyrtimit në shënuesit gjinorë) dhe u klasifikuan në përputhje me gjashtë parimet e politikave të përshkruara në seksionet e mëparshme të vlerësimit. Përkatësisht, secili projekt u shënua si: a) jo relevant me ndonjë prioritet; b) relevant me një prioritet të veçantë, ose c) më shumë se një prioritet njëkohësisht. Në Tabelën 7 më poshtë është listuar numri i përgjithshëm i projekteve me relevancë gjinore në përputhje me relevancën e tyre me pesë prioritetet e politikave. Në total, numri më i lartë i projekteve (49) ishin të lidhura gjerësisht me diskriminimin në punë ose arsim, ndërsa numri i

dytë më i madh (32) ishin të lidhura gjerësisht me temën e dhunës në familje. Fushat e mbetura prioritare kishin një numër shumë më të vogël të projekteve. Sidoqoftë, gjithsej 53 projekte në lidhje me gjininë nuk kishin fokus të qartë në ndonjë nga fushat prioritare.

Tabela 7: Projektet me relevancë gjinore sipas fushës prioritare të politikave

Relevanca	Gjithsej projekte me relevancë gjinore	Dhuna në familje	Diskriminimi në punë ose arsim *	Anti-trafikimi	Qasja në edukimin parashkollor	Të drejtat pronësore	Nuk ka fokus të qartë në fushat prioritare
Shënuesi gjinor 1	<u>14</u>	1	5	0	0	0	
Shënuesi gjinor 2	<u>19</u>	3	15	1	1	3	
Shënuesi gjinor 3	<u>104</u>	25	29	5	0	1	
shënim special			<u>32 projekte</u>	0	0	0	
GJITHSEJ	137	29	49	6	1	4	53

*** shënimet speciale: Në diskriminimin në punë, 32 projekte kanë theks jo të drejtpërdrejtë në diskriminimin institucional por në shkaqet e ndërlidhura ngushtë të ofertës sociale dhe ekonomike që pengojnë gratë, siç janë aftësitë e fuqisë punëtore ose qasja në financa.

Ekziston një paralajmërim i rëndësishëm për numrin e lartë të projekteve në fushën e diskriminimit në punë ose arsim, që ka ndikim në konkluzionet që mund të bëhen lidhur me përafrimin. Numri më i madh i projekteve (49) u përafua gjerësisht me këtë prioritet të politikave. Por, nga një këndvështrim më i afërt, duhet të kihet parasysh se një pjesë e madhe e këtyre (32) projekteve ishin projekte që fokusoheshin në anën e ofertës së punës përmes formave të ndryshme të fuqizimit të grave (gjegjësisht projekte me fokus në aftësitë e fuqisë punëtore, financimin për bizneset start-up etj.). Këto projekte prekin burimet sociale dhe ekonomike të diskriminimit në tregun e punës dhe synojnë të **kompensojnë ekzistencën e diskriminimit**. Ndonëse qasjet e tilla mund të prekin jetën e grave dhe t’iu përkujtojnë partnerët për rëndësinë e nevojave dhe kontributeve të grave, ato shpesh lënë pikëpyetje mbi ndikimin dhe qëndrueshmërinë. Qasje të tilla krijojnë supozimin se ofrimi i mikrokredive dhe i trajnimeve për gratë do t’ua mundësojë grave t’i rrisin të ardhurat e tyre, ose do ta bëjë më të lehtë për gratë që t’i përmbushin përgjegjësitë e tyre gjinore, dhe të përmirësojnë fuqinë e tyre ndikuese dhe statusin e tyre në familje dhe në komunitet. Sidoqoftë, ato nuk adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë aspektet institucionale dhe sistemike të diskriminimit, të normave dhe vlerave që nxisin stereotipa gjinorë dhe mbajnë praktika dhe qëndrime diskriminuese (ato e bëjnë këtë vetëm në mënyrë të tërthortë), që është mandati i të gjitha institucioneve publike dhe më gjerë, siç parashikohet në LBGJ.

Në këtë kuptim, mbetet e papërcaktuar nëse këto programe zyrtarisht janë në përputhje me prioritetet e qeverisë për të siguruar trajtim të barabartë, edhe pse ato mbivendosen në aspektin e qëllimeve të synuara. Kjo kërkon një vlerësim të thelluar të secilit dokument individual të projektit dhe raporteve të vlerësimit të realizuar të projektit, duke marrë në mënyrë ideale rezultatet e synuara dhe ato që nuk janë synuar si dhe përdorimin e një analize të ndikimit gjinor. Duhet gjithashtu të theksohet se rezultatet e vlerësimit të projektit/programit nuk janë përfshirë në PMN, duke e bërë kështu të vështirë të konkludohet se përderisa projektet e donatorëve mund të mos kenë qenë plotësisht në përputhje me prioritetet e qeverisë, rezultatet dhe ndikimi i projekteve të tyre

kontribuan në progresin e agjendës së Kosovës për barazi gjinore. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm i projekteve brenda kësaj kategorie (15 gjithsej) kanë Shënuesin Gjinor 2. Konkretisht, ato janë projekte që trajtojnë gjininë si çështje ndërlidhëse ose që kanë një komponent të fortë gjinor, por brenda një programi më të gjerë. Prandaj, jo të gjitha burimet si pjesë e këtij projekti kanë fokus gjinor dhe ndikimi gjinor është i vështirë për t'u matur. Siç ndodh zakonisht me qasjen ndërlidhëse, gjurmimi i alokimeve dhe shpenzimi i burimeve për komponentët e projektit në lidhje me gjininë vazhdojnë të paraqesin sfida pasi mund të mos jenë bërë të qartë fillimisht.

Një ndarje e projekteve sipas vëllimeve tematike të NZZH-së zbulon se një e treta e NZZH-së me relevancë gjinore nuk shkoj për fushat prioritare të përcaktuara nga qeveria. Në grupin e të dhënave të PMN-së, projektet me relevancë gjinore u shqyrtuan në mënyrë individuale dhe u shënuan nëse ato ishin në përputhje me ndonjë nga pesë prioritetet e qeverisë. Kjo mundësoi llogaritjen e vëllimeve të NZZH-së që shkuan për secilin prioritet të politikave. Përmes kësaj metode mund të konstatohet se pothuajse 1/3 e vëllimit të projekteve me relevancë gjinore (ose 15, 2 milionë euro) shkuan për projekte që nuk përputhen me asnjë prej prioriteteve të qeverisë (shih Tabelën 8). Përsëri, kjo nuk nënkupton që këto projekte mund të mos kenë kontribuar në progresin e përgjithshëm të agjendës së barazisë gjinore – në fund të fundit, ato janë me relevancë gjinore. Sidoqoftë, projektet u fokusuan në çështje që nuk ishin në përputhje me ato që qeveria i konsideroi prioritet gjatë kësaj periudhe.

Të dhënat zbulojnë gjithashtu se pjesa më e madhe e projekteve (të paktën e atyre pjesërisht të përafruara) shkoj për fuqizimin ekonomik të grave. Pjesa më e madhe e vëllimit të ndihmës gjatë kësaj periudhe (49.2 për qind ose 26.6 milionë euro) ka shkuar për Prioritetin 1 ("Antidiskriminim në tregun e punës dhe arsim"). Sidoqoftë, siç u përmend më herët në dokument, një pjesë e konsiderueshme e këtyre programeve (18.3 milionë euro ose 37 për qind e totalit të NZZH-së me relevance gjinore) u fokusua në anën e fuqizimit (aftësi ose qasje në financa) dhe jo në diskriminim institucional. Përmes këtij prizmi është e mundur të theksohet se programet që kanë për fokus të drejtat pronësore (Prioriteti 5) kanë një pjesë të konsiderueshme (16.8 për qind) por kjo kryesisht për shkak të një programi të vetëm të USAID-it për të drejtat pronësore i cili kishte një fokus të ndërlidhur në gjini dhe nuk ishte program me prioritet gjinor. Kemi vërejtur një linjë speciale shtesë për programet që gjatë kësaj periudhe i ofruan qeverisë mbështetje të politikave gjinore (gjithsej 2.1 për qind e NZZH-së gjinore). Këto programe (nisma e financuar nga SIDA në mbështetje të ABGJ-së dhe Mekanizmave Gjinorë të Kosovës dhe mbështetja tjetër e BE-së për integrimin gjinor në IPA) meritojnë një klasifikim të veçantë sepse, ndonëse ato mund të kenë fokus specifik (si në rastin e SIDA-s ku kemi fokus në zbatimin e LBGJ-së), ato gjithashtu kanë fokus të veçantë në mbështetjen e qeverisë për t'i forcuar mekanizmat institucionalë dhe sistemet e politikave publike. Gjithashtu ato synojnë për të rritur kapacitetet organizative dhe të personelit që kontribuojnë në përmirësimin e përgjithshëm të prioriteteve të agjendës së politikave të barazisë gjinore, zbatimin dhe përmirësimin e mundësive dhe rezultateve të përafrimit.

Tabela 8: NZZH gjinore sipas prioriteteve (në euro)

GJITHSEJ NZZH GJINORE	49,425,374
JOPRIORITARE	12,456,528
Prioriteti 1: Antidiskriminimi	25,667,592
Prioriteti 2: Dhuna në familje	3,324,108
Prioriteti 3: Antitrafikimi	1,088,304
Prioriteti 4: Qasja në edukimin parashkollor	1,400
Prioriteti 5: Të drejtat pronësore	7,426,134
<i>*AT për politikëbërje</i>	<i>1,043,226</i>
<i>***Fugizimi</i>	<i>18,375,672</i>
<i>****Të drejtat pronësore gjinore</i>	<i>7,301,991</i>

Tabela 9: NZZH Gjinore sipas prioriteteve (në %)

Lloji i projektit	100%
JOPRIORITARE	29.2%
Prioriteti 1*	49.2%
Prioriteti 2**	6.4%
Prioriteti 3	2.1%
Prioriteti 4	0%
Prioriteti 5***	14.2%
<i>AT për politikëbërje</i>	<i>2.11%</i>
<i>**Fugizimi</i>	<i>37.18%</i>
<i>***Programi për të drejtat pronësore</i>	<i>16.83%</i>

Të dhënat zbulojnë gjithashtu se cilët donatorë dhe agjenci zhvillimore kishin një program më të përafëruar me prioritetet e qeverisë. Kur programet që janë etiketuar nga fusha prioritare të politikave janë të ndërtabuluara sipas donatorëve dhe vendeve, ne kemi mundësi të marrim një pamje treguese të donatorëve dhe agjencive zhvillimore që ishin (në terma të gjerë) më të përafëruar me fushat prioritare të politikave. Të dhënat janë paraqitur në Tabelën 10 më poshtë

Tabela 10: NZZH gjinore sipas fushave prioritare dhe shteteve (përqindja)

VENDI / AGJENCIA	Joprioritare	Dhuna në familje	Diskriminimi*	Antitrafikimi	Qasja në edukimin parashkollor	Të drejtat pronësore	<i>**Mbështetje për politikëbërje</i>
Austria	34%	24%	66%	0%	0%	0%	0%
Finlanda	3%	94%	3%	1%	0%	0%	0%
Holanda	55%	27%	14%	15%	0%	14%	0%
BERZH	0%	0%	100%	0%	0%	0%	0%
BE	20%	6%	64%	8%	0%	0%	2%
Japonia	100%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
Gjermania	90%	0%	0%	10%	0%	0%	0%
Danimarka	0%	0%	100%	0%	0%	0%	0%
Luksemburgu	95%	0%	5%	0%	0%	0%	0%
Norvegjia	10%	12%	85%	6%	0%	0%	0%
Suedia	47%	0%	53%	0%	0%	0%	23%
Zvicra	0%	0%	100%	0%	0%	0%	0%
MB	40%	0%	30%	0%	0%	0%	0%
UN Women	86%	14%	0%	0%	0%	0%	0%
UNICEF	98%	0%	2%	0%	0%	0%	0%
UNDP	5%	2%	94%	0%	0%	0%	0%
UNMIK	45%	55%	0%	0%	0%	0%	0%
UNPF	87%	13%	0%	0%	0%	0%	0%

USAID	30%	0%	0%	0%	0%	70%	0%
-------	-----	----	----	----	----	-----	----

4.2 Dimensionet tjera të përafrimit: çfarë mund të konkludohet?

Nuk ka edhe aq shumë për t'u thënë për tri dimensionet e tjera të përafrimit – përdorimi i sistemeve të vendit, zhvillimi i kapaciteteve të partnerëve dhe përdorimi i sistemeve të prokurimit – sepse ka shumë pak ndihma që kalojnë përmes sistemit ndërsa zhvillimi i kapaciteteve është i vështirë për t'u matur. Shumica dërmuese e projekteve me relevancë gjinore janë projekte të asistencës teknike përmes kontraktuesve ose agjencive zhvillimore, ose grante të dhëna për organizatat e shoqërisë civile. Ka shumë pak raste kur mbështetje e drejtpërdrejtë buxhetore i ofrohet qeverisë (jo vetëm në projektet me relevancë gjinore, por për ndihmat në përgjithësi). Projekti i financuar nga Sida për ABGJ-në 2016-2020, siguroi fonde të konsiderueshme për ABGJ-në përmes projektit të asistencës teknike dhe fondit grant direkt për Agjencinë. Shumica e donatorëve të intervistuar ishin në gjendje të përmendnin vetëm disa raste kur kjo ka ndodhur në pjesë të tjera të qeverisë – një fond grupor në Ministrinë e Arsimit, Mbështetja e Planifikuar Buxhetore Sektoriale të BE-së për Reformën në Administratën Publike, dhe mbështetja aktuale e drejtpërdrejtë për Ministrinë e Integrimit Evropian nga Mbretëria Norvegjeze. Në përgjithësi, donatorët e intervistuar theksuan mungesën e besimit në absorbimin e qeverisë dhe aftësinë teknike për administrimin e fondeve. Sa i përket dimensionit të përdorimit të sistemeve të vendit nga ana e donatorëve, mund të pohohet bindshëm se është i kufizuar vetëm në shkëmbimin e informacionit përmes PMN-së dhe (kur është e mundur) takimeve koordinuese. Kjo gjithashtu nënkupton që sistemet vendore të prokurimit përdoren shumë rrallë. Dimensionin tjetër të përafrimit – zhvillimi i kapaciteteve të partnerëve – është i kufizuar në atë masë në të cilën projektet e asistencës teknike përfshijnë masa për ngritjen e kapaciteteve. Por këto janë të vështira për t'u matur pasi nuk ka asnjë informacion në grupin e të dhënave të PMN-së për këtë variabël.

5. Dinamika e përafrimit: cilat janë sfidat kryesore?

- 1- Gjatë kësaj periudhe, në përgjithësi ka pasur spirancë të dobëta të politikave vendore që i lidhin strategjitë zhvillimore të partnerëve me prioritetet e qeverisë në përgjithësi dhe se politika gjinore nuk ishte përjashtim.

Shumica e partnerëve të Kosovës, të intervistuar për këtë vlerësim, theksuan se në përgjithësi ekziston një kornizë e dobët dhe e paqartë e politikave në Kosovë që udhëheq planifikimin e ndihmës për zhvillim në përgjithësi. Në letër, ekzistonte një kornizë e konsoliduar e politikave në nivelin qendror, me një Strategji Kombëtare për Zhvillim dhe një bollëk të strategjive të tjera sektoriale. Kosova gjithashtu kishte konturet e një sistemi institucional për menaxhimin e politikave (me ZPS-në në qendër të qeverisë) dhe koordinimin e donatorëve (MIE). Por, të intervistuarit vunë në dukje se në praktikë dokumentet e ndryshme kornizë nuk janë të lidhura mirë, akterët në mënyrë jokonsistente aktivë në drejtimin dhe administrimin e agjendës së politikave të vendit, duke shkaktuar kështu mungesë të përgjithshme të koherencës së politikave. Për shembull, u theksua se disa dokumente strategjike sektoriale janë zhvilluar ose miratuar në një mënyrë jokonsistente. Disa nga dokumentet strategjike nënsektoriale janë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga strategjitë e tyre sektoriale dhe objektivat ose masat e politikave nuk përputhen gjithmonë. Për këtë arsye, dokumentet strategjike kombëtare nuk kanë peshë të mjaftueshme dhe

shumë shpesh nuk janë funksionale. Për këtë arsye, ndër të tjera, ato janë lënë pas dore nga donatorët (të cilët, në çdo rast, duket se kanë tendencë të vendosin agjendën e tyre).

Në lidhje me politikën gjinore, Kosova gjatë kësaj periudhe nuk kishte një dokument qendror kornizë (që siç përshkruhet nga LBGJ-ja duhet të jetë Programi i Kosovës për Barazi Gjinore) që mund të përdorej si referencë në dialogun e politikave dhe formulimin e strategjive nga donatorët dhe partnerët. Pesë prioritetet e shqyrtuara këtu në këtë vlerësim gjenden në katër dokumente të ndara (dy strategji sektoriale, një ligj dhe SKZH-ja). Mungesa e një kornize të qartë dhe të komunikuar mirë të politikave i la donatorët pa një platformë të përbashkët gjatë kësaj periudhe, duke e bërë përcaktimin e agjendës së tyre një aktivitet të shpërndarë nga lart-poshtë, pa shumë koordinim.

Secili partner që u intervistua kishte proceset dhe mjetet e veta unike të planifikimit strategjik dhe mënyrat unike se si adreson barazinë gjinore në programimin e tij të zhvillimit. Disa nga donatorët më të mëdhenj kanë strategji globale se si të punojnë në barazinë gjinore; disa prej tyre kryejnë diagnostifikime gjinore specifike për vendin ku veprojnë, që ofrojnë informata për programimin e tyre, dhe të tjerët gjithashtu angazhohen me aktorët në procesin e planifikimit. Për shembull, strategjia e vendit për Kosovën e USAID (2014-2019) u bazua në informatat nga Vlerësimi Gjinor i Vendit (2012) si dhe nga dokumenti global *"Politika e barazisë gjinore dhe e fuqizimit të grave"* (2014). Në vitin 2018, BE-ja gjithashtu kreu një Analizë Gjinore për t'i identifikuar objektivat, treguesit dhe caqet. Donatorë të tjerë më të vegjël dypalësh kanë një qasje më ad-hoc dhe kanë synime dhe prioritate të gjera politike (shpesh rajonale) që më pas formohen në intervenime në diskrecionin e nivelit lokal, kryesisht të kanalizuarra përmes shoqërisë civile. Megjithatë, të tjerët, siç është Mbretëria e Bashkuar, kishin tema globale si *Nisma për parandalimin e dhunës seksuale në konflikt (PDHSK)* e cila kishte vizibilitet të lartë në Kosovë pasi u përqaftua dhe u promovua edhe nga Presidentja Jahjaga.

2- Prioritetet gjinore "humbasin në përkthim" në dialogun e politikave që partnerët kanë me institucionet e nivelit qendror sepse ky dialog bëhet në një nivel që nuk merr parasysh prioritetet e politikave gjinore.

Mekanizmat e vendosur të koordinimit të donatorëve do të duhej të ishin platforma përmes së cilës qeveria drejton dhe cakton agjendën e saj të politikave me donatorët dhe ku çështjet ndërlidhëse si gjinia mund të shikohen në mënyrë më strategjike. Por, intervistat zbulojnë se mekanizmat nuk funksionojnë në mënyrë efektive. Takimet koordinuese të donatorëve (Forumi i Nivelit të Lartë) janë jashtëzakonisht të rralla, ndërsa takimet e grupeve koordinuese sektoriale janë edhe më të rralla. Kur mbahen, ato shërbejnë më tepër vetëm si një platformë për shkëmbimin e informacionit sesa për vendosjen e agjendës. Prandaj, dialogu i politikave midis partnerëve zhvillimorë dhe qeverisë bëhet ekskluzivisht në nivel dypalësh. Për më tepër, bëhet vetëm në nivel të strategjive të përgjithshme zhvillimore të vendit (me institucionet e qeverisë qendrore) ose në nivel projekti (me ministritë e linjës). Këtu, në këto nivele të qeverisë, dimensionet gjinore dhe prioritetet e politikave nuk pasqyrohen ose artikulojnë sa duhet. Pothuajse të gjithë partnerët zhvillimorë e trajtojnë gjininë si një çështje ndërlidhëse ose si pjesë e një teme më të gjerë (p.sh. të drejtat e njeriut) në strategjitë e tyre zhvillimore. Të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e projekteve me relevancë gjinore (41 për qind) kanë shënuesin gjinor 2, që do të thotë se janë projekte tematike që përfshijnë në mënyrë të konsiderueshme dimensionet gjinore. Por ato bazohen në prioritetet që diskutohen

vetëm me agjencitë përkatëse të sektorit dhe jo me ABGJ-në. Në këto konsultime nuk ka asnjë përfshirje apo input të ABGJ-së ose ZBGJ-së. ABGJ-ja thekson se në shumicën e rasteve “donatorët vijnë tek ne vetëm për të na informuar se çfarë bëjnë”.

3- Zhvillimi i programeve dhe projekteve specifike mori në konsideratë perspektivat dhe dimensionet gjinore, por jo domosdoshmërisht në një mënyrë strategjike ose të lidhur me prioritetet e politikave të qeverisë.

Rreth gjysma e partnerëve zhvillimorë të intervistuar vunë në dukje se projektet dhe programet gjatë kësaj periudhe janë ekzaminuar së brendshmi për ndjeshmërinë e tyre gjinore përmes proceseve të mandatuara. Disa donatorë theksuan se agjencia e tyre ka ekspertë gjinorë që punojnë në nivelin e korporatave ose të zyrave rajonale, duke ofruar asistencë teknike në rishikimin e intervenimeve dhe integrimin e gjinisë në to. Disa partnerë zhvillimorë janë gjithashtu të detyruar t’u caktojnë projekteve shënues gjinorë ose madje (si në rastin e ADA) tani e kanë si prioritet të politikës organizative të mos kenë projekte me shënuesin gjinor 0. Sidoqoftë, këto lloje të prioritizimit të brendshëm të ndjeshmërisë gjinore nga ana e donatorëve nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me prioritetet dhe kontekstin e vendit, por thjesht paraqesin përpjekje për integrimin gjinor bazuar në të kuptuarit e donatorëve se cilat janë prioritetet.

Ndërsa shumica e programimit të donatorëve bëhet nga vetë agjencitë zhvillimore, Kosova ka një ndikim të fortë në hartimin e pjesës më të madhe të ndihmës – konkretisht, programimi IPA-s (Instrumenti i Asistencës së Para-anëtarësimit) së BE-së. Çdo vit, në përputhje me Dokumentin Strategjik Indikativ për periudhën (2014-2020), qeveria ndërmerr një cikël programimi për të zhvilluar dokumente veprimi që bëhen pjesë e pakos së IPA-s për vitin e ardhshëm. Zhvillimi i dokumenteve të veprimit kërkon përshkrimin e një logjike të intervenimit dhe një kornizë logjike, e cila zbërthen objektivin e intervenimit nga politika strategjike në nivelin e sektorit dhe deri tek veprimi. E gjithë kjo kërkon jo vetëm ekzistencën e një kornize kombëtare (e cila ishte në fuqi) dhe ekzistimin e një strategjie sektoriale (shumë sektorë e kishin, disa jo), por edhe aftësinë për të identifikuar intervenime specifike dhe të hollësishme. Gjatë kësaj periudhe, BE-ja ka ofruar mbështetje (për rreth tre vjet) për MIE/ministritë e linjës dhe zyrën e BE-së për të ekzaminuar projektet e IPA-s për ndjeshmërinë e tyre gjinore – e ashtuquajturë "tavolina ndihmëse". Por intervistat sugjerojnë që këto intervenime zakonisht erdhën tepër vonë në fazën e hartimit të programit dhe shpesh vetëm kanë bërë ‘redaktim gjuhësor gjinor’ për ta bërë atë më gjithëpërfshirës në vend të integritetit të aktivitetet gjinore që nga fillimi.

4- Aftësia e pamjaftueshme e qeverisë për t’i transmetuar prioritetet e saj gjinore është kryesisht rezultat i fuqizimit të dobët dhe kapaciteteve të dobëta të institucioneve kryesore përgjegjëse, gjë që çon në përafrim të dobët me NZZH-në dhe preferencën e donatorëve për të punuar përmes partnerëve joqeveritarë.

Në lidhje me përcaktimin e politikave dhe të agjendës, ABGJ-ja nuk është mjaftueshëm e fuqizuar që të marrë një rol më udhëheqës dhe aktiv brenda kornizës institucionale. Siç vuri në dukje Analiza Gjinore e BE-së: "Puna e ABGJ-së është penguar nga mbështetja e pamjaftueshme politike, mungesa e stafit, buxheti i pamjaftueshëm dhe dështimi i qeverisë për ta përfshirë atë sa duhet në të gjitha hartimet e politikave"^{vi}. Intervistat sugjerojnë që ABGJ-ja ka kufizime të kapaciteteve për të menaxhuar proceset dhe programet e politikave, me përjashtim të dhunës mbi baza gjinore ku ka ekspertizë signifikative por përballlet me pengesa për t’iu dëgjuar zëri në të gjithë

sistemin institucional. Problemi qëndron në mungesën e zbatimit të LBGJ-së nga Administrate publike për aplikim të instrumenteve të integritetit gjinor dhe vendosjen e ABGJ-së në çdo trup kyç të politikës vendimmarrëse. Në vijim, vendosja e pengesave ose mospasja e një sistemi filtrimi për të siguruar që kornizat e politikave të prodhuara përfshijnë inputet e ABGJ-së, të tilla si : rekomandimet, komentet, analizat dhe transferimin e prioritetëve dhe dispozitave gjinore të cituara në LBGJ, PKBGJ dhe në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në politika të tjera sektoriale dhe nënsektoriale, në nivel kombëtar dhe në atë lokal, e përkeqësojnë më tej mungesën e perspektivës gjinore dhe objektivave zhvillimore gjinore në kornizat e politikave të Kosovës. Për më tepër, ABGJ-ja operon në kuadër të ZKM-së dhe mbështetet në prokurimin e saj dhe ka vështirësi në kontraktimin e shërbimeve cilësore të konsulencës për shkak të mënyrës së zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Sa i përket ZBGJ-ve, analiza gjinore vë në dukje se ata "janë përballur me vullnet të pamjaftueshëm politik për t'i përfshirë ata në proceset e politikave, gjë që potencialisht ka kontribuar në mungesën e perspektivës gjinore në disa ligje dhe politika të Kosovës". Intervistat konfirmuan gjithashtu se ato rrallë përfshihen në diskutime mbi proceset dhe programimin e aderimit në BE. Shumica e ZBGJ-ve kanë kapacitete të dobëta në analizën gjinore dhe proceset e tjera të politikave, gjë që i pengon ata t'i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre. Për më tepër, pasi procesi i hartimit të politikave në administratën publike të Kosovës mbetet një sferë e ekskluzivitetit të disave dhe mungon qasja ndërinstitucionale e përfshirjes, ZBGJ-ve në ministrinë e linjës rrallë u jepet mundësia të marrin pjesë në procesin e hartimit të politikave, gjë që siguron hapësirë të duhur ku ZBGJ-të mund të praktikojnë kapacitetet dhe konceptet e fituara përmes aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve, të organizuara kryesisht nga donatorët.

Në përgjithësi, ekziston koordinim i dobët midis akterëve të ndryshëm të rëndësishëm për zhvillimin dhe menaxhimin e politikave, siç janë ZPS-ja, MIE-ja, ministrinë e linjës dhe ABGJ-ja në marrëdhëniet me komunitetin e donatorëve. I vetmi rast ku ka njëfarë koordinimi është Grupi për Koordinim të Sigurisë dhe Gjinisë, por që është kryesisht në nivel informimi për aktivitete të vazhdueshme në një nën-fushë të veçantë, e jo në planifikimin apo zhvillimin e programit.

Në lidhje me programimin për zhvillim, MIE-ja përballet me kufizime në kapacitetet dhe aftësitë e ministrive sektoriale për t'u angazhuar në komunikim të strukturuar dhe dialog politikash si në kuadër të institucioneve të qeverisë qendrore, ashtu edhe në kuadër të institucioneve të tjera të linjës në ciklin e programimit për IPA-n në përgjithësi, dhe lëre më në integrimin gjinor. Në përgjithësi, kapacitetet e stafit në MIE janë më të larta sesa mesatarja në krahasim në ministrinë e tjera të linjës. Sidoqoftë, kjo nuk shtrihet në fushën e integritetit gjinor në fushat sipas mandatit, siç janë dokumentet e IPA-s ose Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Në përgjithësi, stafi kryesor është në gjendje të kuptojë dhe drejtojë proceset e politikave strategjike, përfshirë këtu punën e prodhuar nga konsulentë të jashtëm tek të cilët MIE-ja duhet të mbështetet shpesh. Sidoqoftë, kufizimet e kapaciteteve shfaqen në lidhje me numrin e njerëzve brenda MIE-së. Numri i stafit në Departamentin e Asistencës Zhvillimore (DAZH) është i kufizuar në krahasim me gjerësinë dhe thellësinë e mandatit të tij. Për më tepër, jo i gjithë stafi posedon aftësi teknike për t'u përfshirë në përgatitjen e projekteve dhe në vlerësimin e dokumentacionit. Duhet të përmirësohet niveli i analizës dhe gjerësia e të dhënave në raportet vjetore

5- Asistenca teknike për t'i mbështetur kapacitetet dhe proceset e politikave/institucionale që synojnë integrimin e gjinisë në hartimin e politikave ka qenë e pamjaftueshme, nuk ka qenë strategjike dhe nuk ka nxitur qëndrueshmëri.

Asistenca teknike është ofruar në nivelin institucional nga disa donatorë për zhvillimin dhe menaxhimin e politikave. BE-ja ka mbështetur MIE-në dhe ministrinë e linjës në programim, ndërsa SIDA dhe GIZ i kanë ofruar asistencë teknike ABGJ-së në fushat e zhvillimit dhe zbatimit të politikave, forcimit institucional dhe zhvillimit organizativ. Sidoqoftë, numri më i madh i donatorëve angazhohet shumë pak ose aspak në forcimin e kapaciteteve të qeverisë për planifikimin e politikave në çdo sektor. Ata preferojnë – kryesisht për shkak se besojnë që qeveria ka kapacitete të dobëta të absorbimit ose nga dëshira për të arritur ndikim të shpejtë – të punojnë përmes kontraktuesve afatshkurtër, agjencive zhvillimore me njësi projektesh në ministri, ose përmes OJQ-ve. Kjo qasje përfundon duke i fuqizuar pamjaftueshëm kapacitetet e institucioneve qeveritare për hartimin dhe menaxhimin e politikave. Kjo reflektohet edhe në aspektin e politikës gjinore. Asistenca teknike në këtë fushë ishte shpesh e pamjaftueshme si në aspektin kohor ashtu edhe në shpërndarjen e burimeve, jo shumë vëmendje i është kushtuar stërvitjes dhe mentorimit, presioni duket se ka qenë kryesisht në arritjen e rezultateve të shpejta, gjë që është krejtësisht në kundërshtim me parimet e zhvillimit të kapaciteteve. Në këtë kuptim, shumica e ndihmave në këtë drejtim duken më tepër ad hoc, të vogla por jo afatgjata dhe strategjike. Prandaj, ekziston nevoja për qasje më strategjike ndaj asistencës teknike të dhënë për t'i fuqizuar: a) kapacitetet e integritit gjinor brenda institucioneve të ndryshme qeveritare – kryesisht ABGJ-së, por edhe ministrive horizontale si MIE-së ose Ministrisë së Financave dhe; b) proceset e hartimit të politikave publike që mbesin pa integrim gjinor.

6- Kapacitetet e donatorëve për ndihmë gjinore janë gjithashtu të pamjaftueshme në nivelin lokal dhe çojnë në mungesë koherence dhe vazhdimësie, veçanërisht në nivel programesh, pasi qeveria nuk e udhëheqë agjendën.

Intervistat shpalosën se pothuajse të gjithë donatorët mbështeten në ekspertizën gjinore nga qendrat rajonale ose selitë e tyre, ndërsa në nivelin lokal pikat fokale gjinore janë zakonisht anëtarë të stafit, puna kryesore e të cilëve është të menaxhojnë programe të tjera tematike. Shkalla e ekspertizës gjinore këtu në nivelin lokal ndryshon midis donatorëve ndërsa qarkullimi i stafit shpesh çon në një ulje të koherencës dhe vazhdimësisë së politikave dhe programimit. Gjatë intervistave, disa nga pikat fokale të intervistuar nuk ishin në dijeni për detajet lidhur me atë se çka është bërë gjatë viteve të kaluara në fushën e gjinisë ose çfarë është qasja e politikës strategjike për gjininë. Me fjalë të tjera, 'memoria institucionale' për temën e veçantë nuk është në nivelin e dëshiruar. Disa donatorë përmendën që ata gjithashtu përdorën konsulentë vendorë ose ndërkombëtarë për t'i mbushur boshllëqet e kapaciteteve të tyre. Donatorët tjerë, të cilët nuk kanë ekspertizë të brendshme gjinore, preferuan të mos angazhohen plotësisht me qeverinë dhe t'i kompensojnë kapacitetet që u mungojnë duke u mbështetur në propozimet e shoqërisë civile. Një qasje e tillë çon në shpërbërjen e mëtejme të përparimit të prioritetëve pasi këto iniciativa megjithëse të dobishme, ishin sporadike dhe nuk i bashkëngjiteshin agjendës më të gjerë të barazisë gjinore në Kosovë. Mungesa e zyrtarëve të kualifikuar gjinorë brenda organizatave të donatorëve pengon dialogun e drejtpërdrejtë midis donatorëve dhe mekanizmave gjinorë në Kosovë, si dhe përafrimin dhe

koordinimin më të mirë me prioritetet e agjendës gjinore në Kosovë. Më tej, një qasje e tillë ka çuar dhe vazhdon të çojë në transferimin e përgjegjësive të qeverisë në shoqërinë civile, çka çon në dobësimin e performancës së institucioneve shtetërore duke i bërë të mendojnë se këto të fundit janë liruar nga përgjegjësia.

7- Përafrimi i NZZH-së dhe hartimi dhe programimi i politikave gjinore gjithashtu rezulton nga shkëmbimi i dobët i të dhënave – përafrimi nuk mund të ndodhë duke pasur mungesë komunikimi.

Partnerët zhvillimore ofrojnë raporte të rregullta në lidhje me projektet e tyre dhe disbursimet e ndihmës në PMN-në e menaxhuar nga MIE dhe sistemi në përgjithësi funksionon mirë, me gjithë të metat dhe mospërputhjet në raportim. Sidoqoftë, siç theksohet në pjesët metodologjike të këtij vlerësimi, është e vështirë të dallohen në PMN projektet relevante për politikën gjinore sepse ato janë të shpërndara në kategori të ndryshme të OBZHE/KNZH dhe nuk janë sinjalizuar se kanë ndonjë relevancë gjinore. Duke qenë kështu, as qeveria dhe as partnerët nuk janë plotësisht të njoftuar se kush çka po bën në këtë fushë. Për më tepër, ka të dhëna të konsiderueshme që donatorët mbledhin nga projektet e tyre. Shumica e donatorëve bëjnë vlerësime periodike të programeve në përgjithësi, por këto janë kryesisht të brendshme ose jo të arritshme ose të ndara me qeverinë. Qeveria nga ana tjetër nuk ka ndonjë sistem për të mbledhur dhe kërkuar vlerësime ose statistika të donatorëve. Pothuajse të gjithë donatorët theksuan se përpjekjet e tyre për integrimin gjinor kanë vendosur një praktikë të ndarjes së të dhënave sipas gjinisë (p.sh. të përfituesve). Por këto të dhëna nuk shkëmbehen me të tjerët, ose nëse shkëmbehen ai shkëmbim është sporadik. Mungesa e të dhënave të qarta për gjininë në PMN (përmes një shënuesi gjinor) ose për mënyrën e raportimit në lidhje me përfituesit e vërtetë ndikon në procesin e hartimit dhe menaxhimit të politikave. Duket se shumë informata janë në dispozicion por nuk mblidhen dhe nuk shpërndahen në një mënyrë që mund t'i bëjë të dobishme dhe efektive.

6. Rekomandime

- 1. Para se të konsiderohet ndonjë përmirësim në përafrim, qeveria e Kosovës dhe komuniteti i donatorëve duhet të përmirësojnë disponueshmërinë e të dhënave për NZZH-në me relevancë gjinore.**

Hapi i parë duhet të jetë përfshirja e shënuesve gjinorë si një variabël e re në Platformën për Menaxhimin e Ndihmës (PMN). Donatorëve do t'u kërkohej të klasifikonin projektet në mënyrë të ngjashme siç është bërë në këtë raport, duke shtuar një shënues gjinor në secilin projekt specifik, i cili do të shënonte shkallën në të cilën projekti ka një komponent gjinor. Për më tepër, pasi sektorët dhe nën sektorët e OBZHE/KNZH shpesh nuk kapin mirë projektet gjinore, MIE mund të punojë së bashku me ABGJ-në për të zhvilluar një taksonomi të kategorive të projekteve gjinore që do të shtoheshin në krye të sektorëve të OBZHE/KNZH. Në këtë mënyrë, ABGJ-ja do të ishte në gjendje që, përmes grupit të të dhënave të marra nga MIE, t'i ndajë automatikisht projektet e donatorëve sipas shënuesit të tyre gjinor edhe kategorisë së tyre specifike gjinore. Praktikisht, të dhënat e marra përmes këtij raporti do të bëhen më të rregullta. MIE gjithashtu mund të përfshijë një kapitull mbi projektet gjinore brenda raporteve të tij vjetore për NZZH-në në Kosovë. Së dyti, ABGJ-ja mund të punojë me donatorët për të krijuar një sistem përmes të cilit ABGJ-ja do të merrte rregullisht të dhëna nga projektet dhe programet me relevancë gjinore. Krijimi i një baze të dhënash të vlerësimeve të projekteve do të përbante të dhëna për çështje të tilla si numri i përfituesve të projektit (d.m.th., rezultatet). ABGJ-ja mund t'i identifikojë lehtësisht këto projekte përmes PMN-së dhe të kërkojë në mënyrë proaktive informata nga donatorët. ABGJ-ja mund të përfshijë informata nga ky grup të dhënash cilësore në raportet e saj periodike dhe të sigurojë që raportet e saj shpërndahen rregullisht.

- 2. Duhet të bëhen përpjekje për t'u siguruar që Plani i ri i Veprimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore të shërbejë si një spirancë e fortë për planifikimin dhe programimin e politikave në të ardhmen**

ABGJ-ja pritet të ketë së shpejti Planin e ri të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore. Ajo duhet të punojë për të siguruar që plani i veprimit të komunikohet dhe duhet të punojë në mënyrë proaktive me donatorët si në mënyrë bilaterale ashtu edhe në grupe për të siguruar që donatorët të jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e tij dhe për detajet. ABGJ-ja duhet të punojë me institucionet e qeverisë qendrore siç është ZPS-ja në Zyrën e Kryeministrit ose me institucionet horizontale siç është MIE për të siguruar që ata të marrin parasysh planin e veprimit në të gjitha aktivitetet dhe që plani të komunikohet prej tyre në marrëdhëniet me donatorët. ABGJ-ja duhet të mbajë trajnime për Zyrtarët për Barazi Gjinore dhe stafin e ministrisë për përfshirjen e elementeve të Planit të Veprimit Gjinor në gjëra të tilla siç janë ciklet e programimit të IPA-s.

ABGJ-ja gjithashtu duhet të punojë me donatorët për zhvillimin e bazës së të dhënave të kontakteve qoftë për pikat fokale të nivelit lokal, ashtu edhe për ekspertët e niveleve të selive për të shpërndarë informacione mbi Planin e Veprimit dhe në përgjithësi për të rritur vetëdijen për ekzistencën e tij. Plani duhet të jetë i qasshëm për publikun dhe shoqëria civile gjithashtu duhet të përfshihet në monitorimin dhe avokimin për zbatimin e tij. Më e rëndësishmja, ABGJ-ja duhet të udhëheqë një grup operacional që do të shërbente si platformë qendrore për mbikëqyrjen e zbatimit të planit.

3. ABGJ-ja duhet të luajë rol shumë më të rëndësishëm në dialogun e politikave midis qeverisë dhe donatorëve në lidhje me strategjitë e ndihmës zhvillimore në përgjithësi.

Siç theksohet në vlerësim, një pjesë e madhe e NZZH-së që shkon në çështjet gjinore kanalizohet përmes projekteve që trajtojnë gjininë si çështje ndërlidhëse. Diskutimet në fazën e planifikimit të politikave të strategjive dypalëshe ose shumëpalëshe të zhvillimit bëhen me institucione të nivelit qendror që mbulojnë portofolet tematike ose institucionet e nivelit qendror siç është ZPS-ja. ABGJ-ja duhet të angazhohet në mënyrë proaktive në këto faza të dialogut. ABGJ-ja mund ta bëjë këtë duke u përfshirë më shumë, dhe duke punuar me pika fokale të donatorëve për barazi gjinore për të kuptuar afatet e procesit të tyre të planifikimit të politikave, duke zhvilluar kalendar të planifikimit të politikave për secilin donator dhe duke i përkujtuar ata që të jenë në kontakt me ABGJ-në. Kreu i Agjencisë duhet të ketë takime të rregullta dhe periodike (çdo vjet ose dy herë në vit) me të gjitha agjencitë kryesore të donatorëve për: a) të shfaqur praninë dhe pronësinë mbi agjendën gjinore dhe; b) të sugjeruar ide se si strategjitë ose programet zhvillimore të partnerëve do të mund të mbështesnin agjendën gjinore në Kosovë.

4. Përpjekjet duhet të intensifikohen për të fuqizuar ABGJ-në, por edhe për t'i forcuar kapacitetet e saj për programim dhe zhvillim të projekteve, veçanërisht në lidhje me IPA.

Donatorët do t'i kushtojnë vëmendje të konsiderueshme rritjes së financimeve dhe të diversifikojnë ndërhyrjet e tyre në mbështetje të punës së mekanizmave gjinorë në Kosovë. Financimi in ABGJ-së dhe mekanizmave gjinorë gjatë gjithë ekzistencës së tyre ka qenë sporadike, i pamjaftueshëm dhe afatshkurtër. Për më tepër, ndihmës i ka munguar orientimi liner për ndërtimin e kapaciteteve dhe nuk ka qenë e lidhur me agjendën e përparësive të barazisë gjinore dhe brenda sistemeve dhe proceseve të politikave qeveritare. Këto çështje duhet të adresohen dhe të merren në konsideratë nga donatorët në programet dhe ndërhyrjet e tyre përmes projekteve për barazi gjinore nëse synohet të arrihen arritje të qëndrueshme dhe progres të dëshirueshëm në nivelin makro të barazisë gjinore.

Zhvillimi i kapaciteteve dhe forcimi institucional janë më efektive nëse zbatohen brenda kornizës së nismave më të gjera të vendit. Ato mund të jenë programe të reformave, agjendave kombëtare, ose kornizave të politikave kombëtare që krijojnë një mjedis rregullues dhe institucional të mundshëm për axhendën e barazisë gjinore. Prandaj, zhvillimi i kapaciteteve dhe forcimi institucional duhet të shoqërohen me programe që përqendrohen në përmirësimin e qeverisjes, transparencës dhe përgjegjshmërisë. Ndihma teknike e asistencës përmes së cilës ofrohen zhvillimi i kapaciteteve dhe ndërhyrjet forcuese institucionale duhet të synojnë qasje që shmangin copëzimin dhe ndarjen e çështjeve gjinore dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një trupi të njohurive mbi çështjet gjinore jo vetëm midis mekanizmit gjinor të Kosovës, por gjithashtu brenda institucioneve publike të Kosovës. Sigurisht, që ndërhyrjet të jenë të suksesshme, ndërhyrjet për zhvillimin e kapaciteteve do të duhet të përshtaten për nevojat e përfituesve dhe në lidhje me mandatin e tyre të punës.

Korinizat e politikave sektoriale dhe ndër-sektoriale, agjendat dhe platformat kombëtare paraqesin pikat të shkëlqyera të ndërhyrjes së donatorëve, për të përmendur disa: Programi i Kosovës për Barazi Gjinore, MSA përmes financimit të IPA-s, Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, etj. Për shembull, IPA është pjesa më e konsiderueshme e ODA-së dhe njëkohësisht, është ajo në të cilën

qeveria e Kosovës ka mundësinë më të favorshme për të projektuar ndërhyrjet e ndihmës në zhvillim. ABGj dhe mekanizmat gjinorë në ministritë e linjës kërkojnë kapacitete më të fuqishme për të qenë në gjendje të punojnë me MIE për të ndërhyrë dhe kontribuar në ciklin e planifikimit të IPA-s dhe hartimi e më shumë dokumenteve të integruara gjinore për IPA. Në vend të projekteve *ad-hoc* ose projekteve ndihmuese (*help-desk*) që veprojnë jashtë nga qeveria dhe jo në përputhje me përparësitë e saj, donatorët duhet të mbështesin ABGJ-në dhe mekanizmat gjinorë në zhvillimin e aftësive të forta të planifikimit të politikave dhe programeve brenda instituconeve të tyre. Këto veprime mund të bëhen përmes mbështetjes afatgjatë për stafin e ABGJ-së për të kontribuar në mënyrë aktive dhe mbështetje të përgatitjes së IPA-s.

5. Donatorë duhet të ngrenë kapacitetet e tyre për planifikim dhe programim gjinor dhe të përditësojnë njohjen e tyre për agjendën dhe kornizat e politikave të barazisë gjinore në Kosovë.

Megjithëse donatorët dhe agjensitë e zhvillimit kanë shënuar rritje në prioritizimin dhe integrimin e gjinisë në të gjitha llojet e mënyrave, personeli përgjegjës për çështjet gjinore shpesh nuk ka një kuptim të mjaftueshëm konceptual të temave ose njohjes për kornizën e politikave vendore gjinore. Për këtë duhet të ofrohen trajnime, të cilat duhet të jetë targetuara, sistematike dhe të vazhdueshme. Insticionet e donatorëve në Kosovë duhet të ndërmarrin një qasje sistematike në menaxhimin e njohurive, duke mësuar nga njohuritë dhe përvoja e tyre për ndërhyrjen e tyre në çështjet gjinore dhe fuqizimin e grave. Agjensitë e donatorëve gjithashtu duhet të punojnë më shumë për të siguruar transmetimin e kujtesës institucionale përmes sistemeve inventarizuese të të dhënave (d.m.th., raporte, baza të të dhënave) në lidhje me politikën gjinore dhe programet për të zvogëluar ndikimin e qarkullimit të lartë të stafit.

Drejtuesit e agjencive të zhvillimit duhet të punojnë me ABGJ-në në zhvillimin e disa trajnimeve orientuese, në të cilat i gjithë personeli lokal i agjencive donatore do të njihej me kornizën institucionale dhe të politikave të Kosovës, si dhe sfidat dhe problemet tematike në vend. Veçanërisht, GIZ dhe Sida në bashkëpunim me stafin e ABGJ-së organizojnë aktivitete të tilla në baza vjetore. Në mënyrë të ngjashme, ABGj mund të sigurojë kontakte të drejtpërdrejta me ekspertë gjinorë të agjencive të donatorëve në Kosovë, rajon e më gjerë dhe madje të organizojë vizita për t'i njohur ata me kontekstin vendor.

6. Donatorët duhen të përfshijnë barazinë gjinore në dialogun për politikën me instituionet e Kosovës dhe të rrisin fondet në mbështetje të agjendës së barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.

Për shumë donatorë dypalësh dhe shumëpalësh përfshirja e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në dialog politik është një detyrim. Pjesa më e madhe e intensitetit të këtij dialogu është e lidhur me udhëheqjen individuale të institucioneve të donatorëve dhe ambasadave dhe shpesh barazia gjinore nuk është sjellë në dialog në mënyrë sistematike. Donatorët duhet të sjellin barazinë gjinore në dialogun e politikave dhe ta përdorin atë dhe mbështetjen e programeve si elemente forcuese në procesin e përafrimit dhe agjendës së përgjithshme të bashkëpunimit. Donatorët duhet të mbështesin dhe kërkojnë pjesëmarrjen e makinerisë gjinore vendore gjatë dialogut të politikave me qeverinë dhe institucionet publike vendore. Ekzistojnë një numër shembujsh të praktikës së mirë në integrimin e makinerisë gjinore të Kosovës dhe barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në dialogun e politikave në ditët e sotme dhe që nuk janë të kufizuara vetëm brenda misionëve të

vlerësimit të vendit, por zgjerohen në dialog të rregullt politikash, vlerësim të përparimit të ndihmës për zhvillim, etj. Praktika të tilla të mira duhet të përqafohen nga të gjithë donatorët si mjete që kontribuojnë në përafrimin më të mirë të politikave dhe maksimizimin e rezultateve.

Arritja e rezultateve të fuqishme të barazisë gjinore kërkon financim të qëndrueshëm në mbështetje të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Rezultatet e këtij vlerësimi, pavarësisht nga çështjet e raportimit të të dhënave siç u vunë në dukje, tregojnë se mbështetja e donatorëve për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave është e mangët nga të gjitha standardet. Pjesërisht problemi qëndron në dy elemente: qasja e donatorëve me shpërndarjen e ndihmave dhe natyra shumëdimensionale e barazisë gjinore. Donatorët janë zhvendosur në një qasje binjake, duke mbështetur investimet direkte në aktivitete për gra dhe/ose vajza në sektorë specifikë, dhe integrimin e një perspektive gjinore në të gjitha politikat dhe programet e donatorëve. Sidoqoftë, integrimi i përgjithshëm nuk ka arritur të përfshijë një orientim të barazisë gjinore në sistemet institucionale, proceset dhe qasjet e donatorëve. Gjithashtu, natyra shumëdimensionale e barazisë gjinore duket se mbetet një sfidë për donatorët në funksionimin rutinë të alokimit të burimeve, duke e bërë të vështirë përputhjen e fondeve me retorikën e politikave.

Për të trajtuar këto sfida, donatorët duhet të ndërmarrin disa ndryshime në praktikën e tyre institucionale. Si hap i parë, ata duhet të ndalojnë ta karakterizojnë "barazinë gjinore" si një çështje e ndërlidhur (cross-cutting) që e bën gjininë më pak të ngjarë të adresohet në mënyrë sistematike në të gjitha fushat e politikave dhe të punojë më shumë drejt zbatimit të integritit gjinor. Integrimi i përgjithshëm duhet të bëhet normë e ditës për të lejuar integrimin sistematik të perspektivave gjinore në të gjitha politikat, programet dhe projektet e donatorëve. Më tej, donatorët duhet të investojnë dhe të marrin një ekspertizë të specializuar që kombinon analizën gjinore me përvojën specifike të sektorit/ëve, aftësitë e veçanta të kontekstit dhe njohuritë mbi funksionimin e administratës publike dhe organizimin e reformave.

Burimet:

- ⁱ OBZHE: “Deklarata e Parisit mbi Efektivitetin e Ndihmës”
https://www.oecd-ilibrary.org/development/paris-declaration-on-aid-effectiveness_9789264098084-en
- ⁱⁱ Qeveria e Kosovës: “Strategjia Kombëtare për Zhvillim” http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf
- ⁱⁱⁱ Qeveria e Kosovës: “Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë”
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/SKDP_17_10_2016_ENG.pdf
- ^{iv} Rregullorja e Qeverisë 09/2015 “Për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës”
http://MIE-ks.net/repository/docs/20170511082316_rregullore092015peerkoordiniminedonatorvetejashtemnerepublik.pdf
- ^v Shënuesi Gjinnor
<https://www2.wpro.who.int/internet/files/eha/toolkit/web/Technical%20References/Gender/IASC%20Gender%20Marker%20FAQs.pdf>
- ^{vi} Analiza Gjinnore e Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës
<https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/womens-network.pdf>